



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12.060/04-9943 dt. 21.02 2020

Mbledhja e rregullt  
Kuvendi Komunal  
31. 01.2020

### PROCESVERBAL

I mbledhjes se rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 31.01.2020

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

#### Rend dite:

1. Betimi i asamblastit të ri Përparim Bajraktari nga Partia e subjektit politik, Vizioni për Drenasin, pas dorëheqjes së asamblastit Endrit Gllarevea, në Kuvendin Komunal Drenas.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.12.2019.
3. Draft - Propozim; Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2020 -2024.
4. Propozim – Vendim; Shqyrtimi publik i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit për periudhën 2020-2028.
5. Plani vjetor i Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020
6. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2019:
  - a. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
  - b. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
  - c. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.
7. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar – dhjetor 2019.

8. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit.
9. Draft - Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020. E plotësuar.
10. Të ndryshme.

*Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 31 /01/ 2020 ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, nënkryetari Nazmi Hasi, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, përfaqësues të KDI-së, përfaqësues të OSCE-së, si dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse.*

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj;** pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoj se prezent në mbledhje janë 28 pjesëmarrës. Para se të filloj me rendin e ditës, i uroj mirëseardhje Fitores dhe Përparimit, i uroj suksese dhe punë të mbarë.

Duke hapur diskutimet për rendin e ditës, ju njoftoj se kemi një pikë shtesë të rendit të ditës: 1. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020, me përmirësim.

Atëherë ftojme z. Përparim Bajraktari të bëj betimin si asamblist i ri.

**Përparim Bajraktari** – Unë, Përparim Bajraktari, “betohem dhe deklaroj solemnisht se do t’i kryej, me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glllogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë, për të gjithë”.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj** hodhi në votim edhe një pikë shtesë. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020, me përmirësim.

Ky rend ditë u votua në mënyrë unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj** Kalojmë tek pika e dytë;

2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.12.2019. Ju ftoj për diskutim, vërejtje apo sugjerime, nëse nuk ka, kalojmë në votim. Votojmë prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar:

*Për votuan 27 anëtar*

*Kundër s’ka*

*Abstenim s’ka.*

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj;** kalojmë tek pika e tretë,

3. Draft Propozim strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal 2020 -2024. Ju ftoj për diskutim, vërejtje apo sugjerime, nëse nuk ka, kalojmë në votim.

*Për votuan 28 anëtar*

*Kundër s'ka*  
*Abstenim s'ka*

**Pika e katërt:**

**4. Propozim Vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit për periudhën 2020-2028.** Fjalën e ka drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu.

**Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu;** Duke u bazuar në vendimin e Ministrisë së Mjedisit për Planifikimin Hapsinor me datë 17.01.2020, me numër 6225/2019, është dhënë pëlqimi dhe është marrë vendim për hapjen e shqyrtimit publik të planit zhvillimor komunal. Paraprakisht po e paraqes një rezymë të shkurtër rreth projektit para se të hidhet në votim.

Bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Glllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës. Procesi i hartimit të PZHK-së ka filluar me vendimin për hartimin e PZHK-së marrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit më datë 31.01.2018, në të cilën bartës i procesit të hartimit të PZHK-së është përcaktuar Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit. Për të udhëhequr procesin e planifikimit në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, komuna ka themeluar dy mekanizma: Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) dhe Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK).

Procesi i hartimit të PZHK-së ka kaluar në katër faza kryesore siç janë: profili, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor, dhe prioritetet strategjike me planin e veprimt. Të gjitha fazat janë përcjell me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe aktorëve të tjerë relevant dhe me mbajtjen e punëtorive për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028. Për të vazhduar me procedura të mëtutjeshme për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën kohore 2020-2028, bazuar dhe në nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe nenit 20 të Ligjit Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, ju ftoj të miratohet propozim vendimi për shpalljen në shqyrtim publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit në të cilën u nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut në afat prej 30 ditëve dhe pas përfundimit të afatit do të përcillet në Ministri të Mjedisit për marrjen e pëlqimit përfundimtar dhe pastaj të dërgohet propozim vendimet për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal, i cili është shumë i rëndësishëm dhe përcakton zhvillimin e komunës për tetë vitet e ardhshme. Prandaj, duke u bazuar në pëlqimin e ministrisë që ta hapim një shqyrtim publik si dhe duke ju ftuar edhe në hapje të shqyrtimit publik, ne ju ftojmë ta miratoni këtë propozim vendim.

**Vehbi Berisha** - Kam vetëm një pyetje. Sipas propozim vendimit që është dhënë për shqyrtimin publik të këtij plani. A do të duhej të ishin përcaktuar në këto nene edhe datat se kur bëhet shqyrtimi publik?

**Drejtresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu;** Datën kemi mundur ta vendosim në projekt propozim për shqyrtim publik, mirëpo është edhe njoftimi publik që besoj do dal sot pasdite, ngase shkon edhe me përfaqësues të ministrisë së mjedisit përfaqësues të GIZ-it dhe të gjithë ata që kanë kontribuar dhe është dashur një përshtatje e agjendave të tyre. Po ashtu të respektohet afati pesë ditor i ligjit, për njoftim publik. Për këtë arsye nuk është përfshirë në propozim vendim ngase mund të ketë ndryshim. Në fillim të shkurtit do të mbahet shqyrtimi, hapjen e shqyrtimit publik e bën krytari i komunës në prani të përfaqësuesve dhe ministrisë së mjedisit për shkak se është obligative, po ashtu edhe të GIZ-të gjerman, kompanisë projektuese, ekipit komunal dhe të gjithë qytetarëve, e cila do të bëhet në sall të kuvendit.

**Sabrie Kukaj;** A përcaktohet me ligj 30 ditë afati i komenteve dhe bisedimeve me publikun apo duhet të jetë më i gjatë se 30 ditë ?

**Drejtresha Për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu;** Siç e ceka edhe me herët në udhëzim administrativ po ashtu edhe në vendim, pëlqimi është dhënë për 30 ditë , ngase me udhëzim administrativ të Ministrisë së Mjedisit është përcaktuar që pjesëmarrja publike dhe shqyrtimi publik është 30 ditë dhe përpilohet një raport. Ky raport dërgohet në ministri dhe inkorporohen në planin zhvillimor të gjitha dokumentet, rekomandimet që janë dhënë nga qytetarët, pastaj kthehet përsëri nga ministria dhe besoj që deri në muajin tjetër ta kemi edhe këtu Planin Zhvillimor Komunal për Miratim 2020-2028.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj;** Ka diskutime të tjera? Jo. E hedhim në votim. Votojmë tani prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar:

**Për votuan 28anëtar**

**Kundër s'ka**

**Abstenim 1 .**

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj:** hapi diskutimin për pikën e pestë  
**5 -Plani vjetor i Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020.**  
Ja japim fjalën Kryetarit të komunës.

**Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci:** Pasi përshëndeti të pranishmit. Ky plan vjetor është përgatitur nga zyra ime dhe nga drejtoritë e komunës bazuar në kërkesa dhe në nevoja të qytetarëve si dhe në dëgjimet publike për buxhet. Unë jam në dispozicion të juaj për çdo kërkesë, për çdo diskutim që është i nevojshëm për sqarime .

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj** -Pasi që kjo pikë nuk votohet, kalojmë tek pika radhës.

**6 - Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2019:**  
**a. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.**

**b. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

**c. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara.**

I ftojme të na prezantojnë raportin vjetor në pika të shkurtra secilin përfaqësues të komiteteve. Ja japim fjalën përfaqësuesit të Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.

**Gentrit Mulaku;** Më datë 25.10.2019 Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport patën një konsultim me drejtorin e Drejtorisë për Arsim në komunën e Drenasit z. Tafil Halilaj, ku përveç tjerash diskutuam edhe për çështjet në vijim:

1. Ndarja e orëve dhe ndarja e normativit
2. Pushimet pa pagesë
3. Konkursët të rregullta dhe plotësues
4. Shpallja e vendeve të lira të punës
5. Profilet e shkollës profesionale
6. Hartimin e rregullores për shkolla

Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport më dt. 06.12.2019, ka mbajtur mbledhjen konsultative me drejtoreshën Shqipe Zogu, drejtoresha e DKRS-së, ndër të tjera diskutuan në këto pika:

1. Buxheti i DKRS-së për vitin 2020 (ndarja e buxhetit për sektorët Kulturë, Rini dhe Sport)
2. Ndarja e subvencioneve nga DKRS (koha më e përshtatshme për ndarjen e subvencioneve për vitin 2020)
3. Mundësia për riaktivizimin e festivaleve, të cilat janë organizuar tradicionalisht në Komunën e Drenasit, siç janë "Revista Burimore e Folklorit", "Ditët e Humorit", etj.
4. Ligjit për Ansamblin e Qytetit, mundësia e implementimit të këtij ligji në Komunën e Drenasit
5. Ligji për teatrot, mundësia e implementimit të këtij ligji në Komunën e Drenasit
6. Planet për ndërtimin e godinës së Muzetë, Kinemasë dhe Teatrit në qytetin e Drenasit
7. Skena Profesionale për aktivitete të ndryshme kulturore-artistike si dhe zërmë profesional
8. Dekorimi i qytetit për fund-vitin si dhe planet për organizimin e aktiviteteve kulturore-artistike

**Vehbi Berisha;** Duke qenë se komitet në përgjithësi kanë rol konsultativ janë edhe këshill dhe me intereson të di që ky raport i juaj për pos që është pasqyruar vetëm një rend i ditës, që ju i keni mbajtur takimet e juaja mujore ose me pak se mujore mungojnë konkluzione, rekomandimet për shkak se ky kuvend e ka dhënë dritën jeshile që me u zgjidh ky komitet që ju si ekspertë të fushës që jeni zgjedh me konkurs legjitim publik të jepni rekomandime dhe konkluzione në lidhje me fushat që jeni zgjedh me i dhënë këto këshilla, pse mungojnë këto konkluzione, këto rekomandime, të cilat për mendimin tim do ta bënin më të plotësuar këtë raport të juaj.

**Gentrit Mulaku-** Ne si komision jemi formuar shumë vonë dhe nuk kemi arritur me i përfshi të gjitha me një raport dhe me jap rekomandime.

**Nexhmedin Balaj-** Me raportin e Komitetit pajtohem plotësisht me parafolësit, sidomos z. Vehbi e ceku se duhet me qenë këshillues dhe duhet me pas rekomandime, mirëpo gjithmonë unë kur dua ta kritikoj dikë dua me i marrë edhe përgjegjësitë tona. Ne e kemi pas një panel intervistues

që e ka bërë përzgjedhjen e tyre dhe u dashtë gjithsesi dikush që ka qenë anëtar i komitetit, i viteve me herët me qenë edhe ne komisionin vazhdues sepse i kish inkorporuar përvojat i vitit të kaluar sepse pikërisht këta kanë ngec këtu në raport, ndoshta këta ne teren kanë bërë një punë shumë të mirë, mirëpo raporti është shumë i mangët sidomos në drejtorinë e arsimit. Për me dhënë rekomandime, se pari duhet me pas të njohur problemet në arsim, pra duhet me marrë informata të sakta dhe të mjaftueshme se ku po ngec arsimi në komunën e Drenasit që kemi shumë vërejtje, duhet me i ditë dukuritë, sepse këta janë marrë vetëm me anen procedurale, apo me anën teknike, që drejtori këto procedura shumë mirë i njeh dhe i zbaton ato, por është mirë më i sqarua ne cilat dukuri po ngec arsimi tek ne, nëpër shkolla. Cila është procedura e mësimdhënies por prapë po kemi mangësi tek ato shkolla. Me komitetin për komunitete ne kemi pas një kërkesë ku na është shfaq populizmi ne shkolla populizmi nashta është një problem shumë i vogël sa janë dukurit tjera siç janë droga alkooli te mosha rinore. Pikërisht unë mendoj që ju ka munguar përvoja, ky komision duhet të ndalet ne thelbin e asaj se cilat janë problemet në arsim, pastaj me njoft mirë problemin ekspertët e lamis që këta ekspertë e bëjnë një punë shumë të mirë, qe me kulturë kanë bërë një program shumë të mirë, mirëpo tani mundemi me banë një projekt për populizëm me i sensibilizua nxënësit që alkooli, duhani drogat janë të dëmshme por edhe një projekt për me i vëzhgua mësuesit tonë sepse e keni mandatin e kuvendit dhe me vëzhgua pse mësuesit në shkollat tona nuk janë ashtu siç ne dëshirojmë.

**Petrit Gashi;** Doja ti tregoja Nexhit se komisioni është zgjedhë dhe është konsultativ, neve na intereson se çka kanë punuar në teren dhe jo vetëm për pikat e rendit të ditës. Problemi është se ka pasur mangësi jashtëzakonisht të mëdha, sidomos në sektorin e Arsimit. Rekomandimet në sektorin e Arsimit në sektorin e drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, ki mjaftueshëm material për me nxjerr rekomandime, nëse vetëm çështjet e anëtarëve të asamblesë komunale me i pas marr me i shtjellu besoj që kishin dalur rekomandime të mjaftueshme në këto fusha. Nuk dojna me akuzua anëtarin e komisionit, thjesht kjo është një këshillë që në vitet në vazhdim mej marr parasysh këto, që të paraqitni një pasqyrë reale dhe të na ndihmoni edhe neve me i pa të metat në sektor të caktuar.

**Sokol Bylykbashi;** Kemi tri raporte të Komiteteve Konsultative që janë trupa ndihmës dhe ndihmojnë komunën në bërjen e politikave dhe strategjisë. Kam një vërejtje që ju shkon të tri raporteve në vazhdim të raportit të punës të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuar sepse është një raport pak ma ndryshe. Duke marr parasysh qe këto komitete janë formuar vonë dhe nuk kanë shumë muaj që kanë vepruar, megjithatë aty ku ka vullnet, ide , energji edhe një mbledhje me mbajt po besoj që duhet me pas rezultat, ndoshta defekti është që ju nuk keni shkruar që ju duhet të keni kujdes herëve tjera. Dëgjova që the kemi diskutuar, ka pas ide, por nuk i keni shkruar, këto duhet me pas të shkruje gjithqysh me i shkrua, në raport me neve , në raportim ti je minus por ti si të dush.

E thanë edhe kolegët se raporti duhet me i pas dy gjera, konkluzionet që janë një lloj skanimit i gjendjes të përgjithshme në atë fushë që ju e përfaqësoni. Në konkluzione ju duhet ta tregoni gjendjen faktike brenda asaj fushe cilat janë problemet, defektet nevojat e të gjitha këto. Me rekomandime ju tregoni me hapa konkret se si mundë të bëhet një drejtori e caktuar për me i zgjedh ato probleme, përveç kësaj është edhe diçka tjetër me rëndësi, duhet me tregu kur të sillni raportin vjetor në vitin që jemi, me na tregu në fund të vitit idetë, rekomandimet që i keni dhënë ju sa janë përmbush ju përveç se monitoroni fushën që ju jeni, duhet me monitorua edhe komunën.

**Gentrit Mulaku;** Pajtohem me këshillat dhe sygjerimet e parafolësve që të bëhet një raport më i gjerë sa i përket këtij komiteti ne vitin e ardhshëm.

**Kryetari Ramiz Lladrovci;** Edhe unë jam dakord me parafolësit, raporti ka pasur nevojë me qenë më i qartë dhe ti ketë pasur edhe 4-5 paragrafë për rekomandimet të cilat po folni ju.

**Sabrie Kukaj;** Desha një njoftim, rregullorja për punën në Arsim, komisioni që jam kemi mbajti disa takime dhe ajo është gati. Ne do të diskutojmë që kjo rregullore do të jetë për të gjithë njesoj nëpër Shkolla.

**Petrit Sinani;** Ne duhet të i përkrahim këto komitete sepse kjo është hera e parë dhe nuk duhet paragjykuar, sepse nëse tani e pyesim z. Mulakun a kishte dashur që ky raport me qen i kompletuar? Ai sigurisht që kishte dashur, që këtij raporti të mos i mungonte asgjë. Deshta me cek që komitetet nuk e kanë rolin e auditorit si u konstatua nga disa koleg, komiteti nuk është që të konstatoj gjendjen, komiteti jep vetëm rekomandime dhe ju jepni rekomandime çka mendoni me ndryshu në Arsim, Kultur, Rini dhe Sport këtë punë e keni , nuk e keni punën ju me japë konkluzione ato punë i ka auditori.

**Gentrit Mulaku;** Ne si komitet kemi qenë të informuar që është një rregullore është hartuar po nuk ekemi parë në detaje se çka është diskutuar ne të. Diskutimi tek norma e mësimdhënësve është shumë primare në Drenas.

**Kryetari Ramiz Lladrovci;** Jep sqarime rreth plotësimit të normës së plotë të mësimdhënësve dhe arsyes për mos hapje të konkurseve së jashtme.

**Gentrit Mulaku;** Pajtohem plotësisht me kryetarin, se në vitet paraprake ka pasur shumë mësimdhënës pa plotësimin e normave.

**Petrit Gashi;** Ne patëm diskutim për anëtarin e komisionit për me i dhënë këshilla për vitet tjera që të bëhen raporte më të detajuara.

**Sokol Bylykbashi;** Komitetet Konsultative nuk kanë nevojë neve me na njoftua se sa po zbatohen rekomandimet e tyre nga ana e ekzekutivit për shkak se këtë e bën auditori, nuk është ashtu. Auditori nuk merret me rekomandimet e Komiteteve Konsultative, auditori merret me rekomandimet e veta se a janë zbatuar a jo dhe këto i përcjell vit pas viti.

**Petrit Sinani;** Veç duhet me dit dallimin e fjalës konkluzion dhe rekomandim si të kuptosh këtë dallim ne rregull jemi, unë thash konkluzionit nuk thash rekomandimit.

**Kryetari i komunës Ramiz Lladrovci;** Edhe ky raport është i mjaftueshëm, vetëm se kanë bërë rekomandime vetëm nuk ja kanë shkruar rekomandim, kanë diskutuar për disa çështje vetëm mungon rekomandimi.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj;** Ja japim fjalën përfaqësueses së Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

**Fitore Sefiu-** I përshëndesë të gjithë të pranishmit. Ne përfaqësojmë Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale , dhe siç e diskutuam edhe më herët komiteti është formuar në fund të muajit shtator gjë që kanë mbet vetëm tre muaj deri në përfundim të vitit 2019. Ne këtë komitet jemi pesë anëtarë Fitore Shabani , Blerim Dvorani , Arbresha Haziri, Violeta Ibshi- Bujupi dhe Basri Gashani .

Takimi i parë

Mbledhja e parë e Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është mbajtur me 09.10.2019.

Temat e trajtuara ishin: Zgjedha e kryesuesit të Komitetit, Zgjedhja e zëvendës kryesuesit si dhe diskutimi rreth Udhëzimit Administrativ, funksionimit dhe kompetencave të Komiteteve Konsultative.

Kryesues I Komiteti Konsultativ për zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është zgjedhur Fitore Sefiu-Shabani, ndërsa zëvendës kryesues është zgjedhur Burim Dvorani.

Takimi i dytë

Takimi I dytë është mbajtur me 26.11.2019. Në këtë takim kemi shqyrtuar një kërkesë të banorëve të komunës së Drenasit më konkretisht të objektit banesorë "Altrade Holding" e cila gjendet në rrugën Bedri Shala. Siç thuhet nga banorët në hyrje të ndërtesës janë vendosur dy kontenier të mbeturinave të cilat bëjnë pengese për banorët në hyrje-dalje të ndërtesës si dhe nga kundërmimet e mbeturinave. Problemi në fjalë është drejtuar drejtorisë përkatëse përkatësisht Drejtorisë për Emergjencë.

Po ashtu takuam edhe me drejtoreshën për Zhvillim Ekonomik me znj. Egzona Jetullahu.

Takimi ishte më tepër një takim njoftues duke shqyrtuar edhe mundësitë e bashkepunimit në të ardhmen.

Takimi i tretë

Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik ,Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS) , u mbajt më 06.12.2019.

Ndër të tjerat që u diskutuan ishin edhe takimi me drejtoreshën e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë znj. Lumnije Krapit. Në këtë takim u konsultuam për problemet e qytetarëve të komunës së Drenasit në fushat të ndryshme si me ujë të pijshëm, ndotje të ambientit nga qytetarët e pandërgjegjshëm nga mbeturinat dhe ujërat e zeza.

Po ashtu takuam edhe kryesuesin e Kuvendit Komunal të Drenasit z. Labinot Halilaj. Takimi me z. Halilaj ishte një takim formal njohës si dhe informues rreth Kuvendit.

Konkluzione

Megjithë faktin që ne si komitet jemi formuar në fund të vitit 2019, me përkushtimin tonë si komitet dhe me ndihmën e zyrtarëve të drejtorive të komunës së Drenasit, kemi arritur një bashkëpunim duke u munduar t'u dalim në ndihmë qytetarëve tonë.

Besojmë dhe shpresojmë se së bashku do të arrijmë të jemi një urë bashkëpunuese në mes qytetarëve dhe shërbyesve komunal.

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, në komunën e Drenasit, është themeluar në muajin shtator 2019, dhe përbëhet prej pesë anëtarëve, njohës të mirë të aftësive të kufizuara. Ky komitet, në përbërje prej këtyre anëtarëve, është përzgjedhur sipas konkursit nga Paneli Intervistues i Kuvendit Komunal të Drenasit, dhe si i tillë organizon mbledhje formale dhe jo formale, përmes të cilave priorizon aktivitete për PAK. Mbledhjet formale, zakonisht ky komitet i mbanë në zyrën pranë byfësë në Komunën e Drenasit, kurse mbledhjet jo formale dhe takimet tjera konsultative i zhvillon në terren dhe sipas rastit.

Me qëllim të transparencës, ky Komitet ka përmbledhur një raport me qëllim të informimit të komunitetit të aftësisë së kufizuar, si dhe të institucioneve komunale për punën dhe aktivitetet tona si Komitet Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), përgjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2019. Duke qenë transparent dhe duke iu përmbajtur kontinuitetit në raportim, Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara i Komunës së Drenasit, publikon këtë raport për të përmbledhur punën, aktivitetet dhe mbledhjet e realizuara.

Ky organ drejtues i ri institucional, i formuar për herë të parë në komunën e Drenasit i cili vepron në harmoni me “Udhëzimin Administrativ Nr. 01/201

6, për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna”, përmes mbledhjeve të realizuara ka shqyrtuar dhe diskutuar në hollësi detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit dhe të secilit anëtar veç e veç. Specifikisht, si qëllime dhe detyra prioritare të këtij komiteti janë vënë: nxitja, mbrojtja dhe sigurimi i mundësisë që të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara në territorin e Komunës së Drenasit t’i gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre, sa u përket specifikave të këtyre personave dhe domenit të nivelit komunal të qeverisjes, e kjo gjithnjë në bashkëpunim të përhershëm me institucionet komunale, me OJQ-të e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe me vet Personat me Aftësi të Kufizuara.

Përveq mbledhjeve formale, ky komitet ka mbajtur edhe takime të tjera jo formale - konsultative, përmes të cilave janë konkretizuar ide dhe specifika në aspektin e përmirësimit të gjendjes së Personave me Aftësi të Kufizuara - PAK në komunën e Drenasit. Me anë të zhvillimit të këtyre kontakteve me institucione dhe me individë, ne si Komitet për PAK kemi konsideruar se mund të jenë aleatë të orientimeve të tija për të drejtat dhe mundësitë e këtyre personave.

Gjithashtu, Komiteti Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara së bashku me institucionet komunale dhe me Organizatat Jo qeveritare u dakorduan të fillojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e Aftësisë së Kufizuar, bashkëpunim ky i cili do të jetë në shërbim të PAK, sepse ndryshe, mungesa e bashkëpunimit pasqyron jo dobi në shërbim të këtyre personave.

Përgjithësisht, në periudhën raportuese dhe sipas rregullativës së Kuvendit Komunal të Drenasit, Komiteti ka mbajtur katër (4) mbledhje të rregullta, gjithashtu ka lidhur kontakte përmes email-it dhe ka mbajtur më se shtatë (7) takime konsultative ne si anëtarë por edhe me përgjegjësit digasterialë të drejtorive komunale, OJQ etj.

## (II) PJESA TEMATIKE, MBLEDHJET

Mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (11.07.2019)

Me datë 11.07.2019 u mbajt mbledhja e parë e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në sallën e Kuvendit Komunal të Drenasit. Kjo mbledhje në fakt është realizuar pas

përzgjedhjes sonë si anëtarë, por ende pa u proceduar komiteti në mbledhjen e asamblesë komunale. Mbledhja e KKPAK, filloi në orën 13:00, dhe procesverbali është mbajtur nga njëra ndër anëtarët e zgjedhura të këtij komiteti-Ariana Isufi. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin pesë anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Burim Fazliu, Jehona Abdyli dhe Shemsi Bërbatovci. Pasi u konstatua se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët, u propozua rendi i ditës. Rend dite kishim:

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara
2. Zgjedhja e zëvendës kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara
3. Të ndryshme

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës kemi diskutuar për zgjedhjen e kryesuesit të këtij komiteti. Njëri nga anëtarët e këtij komiteti, përkatësisht Burim Fazliu, ka propozuar për kryesues Shemsi Bërbatovci, i cili unanimisht është zgjedhur si kryesues me votat e të gjithë anëtarëve të tjerë.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, Jehona Abdyli ka propozuar që për zëvendës kryesues të zgjidhet Ariana Isufi, e cila po ashtu është zgjedhur unanimisht me votat e të gjithë anëtarëve. Pas votimit njëzëri të këtyre dy propozimeve, është kaluar në pikën e radhës.

Në pikën e tretë të rendit të ditës, diskutuam mbi Udhëzimin Administrativ në harmoni me të cilin veprojmë ne si komitet, për planifikimin e detyrave dhe obligimeve që kemi.

Me kaq mbledhja e datës 11.07.2019 mori fund në orën 14:20.

Mbledhja e dytë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (11.10.2019)

Pjesëmarrës në këtë mbledhje ishin pesë anëtarët e zgjedhur të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara: Shemsi Bërbatovci - kryesues i Komitetit, Ariana Isufi- zëvendës kryesues, Arlindë Krasniqi- anëtare, Burim Fazliu- anëtar, dhe Jehona Abdyli – anëtare. Nga ky takim, ne kemi diskutuar në lidhje me këto pika:

1. Propozimi për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësiwe mes anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, lidhur me aktivitetet që do të realizohen deri në mbledhjen e radhës.
2. Planifikimi dhe shqyrtimi i mundësive për daljen në terren, në vizita për PAK.
3. Planifikimi për takim dhe bashkëpunim me Organizatën “Handikos” në Drenas dhe shkëmbim përvojash.

Lidhur me këto pika të rendit të ditës, komiteti në fjalë ka propozuar të identifikohet dhe hulumtohet më shumë mbi gjithë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat më të afërta të rregullta. Diskutimin e kemi vazhduar duke rekomanduar marrjen e më shumë informatave në aspektin infrastrukturor në komunën e Drenasit si dhe kemi ngritur si çështje shërbimet shëndetësore që u ofrohen PAK, në institucionet private dhe ato publike.

Mbledhja e tretë e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (11.11.2019)

Në mbledhjen e tretë, kemi nxjerrur diskutimet si më poshtë:

1. Gjetja e mundësive për bashkëpunim me Handikos Shoqata të tjera në Drenas, lidhur me konkretizimin e iniciativave të përbashkëta për Personat me Aftësi të Kufizuara.

2. Bashkëpunimi me DKA në Drenas lidhur me identifikimin e numrit të nxënësve me Aftësi të Kufizuara në shkolla si dhe diskutimin për asistentët ekzistues më këta fëmijë/nxënës, dhe diskutim për mundësitë ligjore dhe buxhetore në këtë drejtim

Bazuar në pikat e ngritura për rend dite, perkitazi me aktivitetet e planifikuara është rekomanduar formimi i trekëndëshit të bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për PAK, si dhe shërbimet e domosdoshme që ju ofrohen aktualisht, dhe çka duhet të u ofrohet kësaj kategorie.

Përkritazi me pikat e ngritura të rendit të ditës dhe nga takimet që kemi realizuar me Handikos, në kemi shkëmbyer një varg idesh lidhur me hapat që do të marrim për të përmbushur objektivat tona të përbashkëta, që më së shumti do t'i kontribuojnë PAK.

Përgjatë takimit me Handikos në zyrat e tyre, ne kemi diskutuar së bashku me menaxherin e Handikos z. Behxhet Binaku dhe stafin e tij edhe në lidhje me Planin e Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara, me ç'rast Handikos ka punuar një dokument të tillë, të formalizuar për vitin 2018, së bashku me ekipin punues, duke përfshirë kështu në mënyrë të detajuar të drejtat e PAK, dhe çështjet me prioritet për këta persona, në fushat: Arsim, Mirëqenie sociale, Shëndetësi, Punësim, Mbrojtje ligjore, Qasje informim, Komunikim, Pjesëmarrje dhe Statistika, mirëpo ky dokument nuk ju është aprovuar nga asambleja komunale. Megjithëse, ne do të punojmë në këtë drejtim, dhe në këtë Plan të Veprimit do të jenë të përcaktuara aktivitetet, treguesit, mjetet e verifikimit, synimet e secilit aktivitet, afatin kohor të realizimit si dhe koston financiare të përlogaritur për secilin aktivitet, në të gjitha fushat e përmendura nga lartë.

Mbledhja e katërt e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara (23.12.2019)

Përgjatë mbledhjes së tretë dhe të fundit për vitin 2019, kemi reflektuar në pikat e rendit të ditës së mbledhjes së kaluar, dhe kemi diskutuar për mundësitë për realizimin e tyre, sfidat dhe rezultatet e arritura. Të pranishëm në mbledhje ishin pesë anëtarët e këtij komiteti, përkatësisht: Ariana Isufi, Arlindë Krasniqi, Jehona Abdyli, Shemsi Bërbatovci dhe Burim Fazliu, Pas këtij diskutimi, pjesa e dytë e takimit ju është përmbajtur pikave të rendit të ditës, të cilat ishin:

1. Parashtrimi i kërkesës në Qendrën për Punë Sociale (QPS), për një takim konsultativ lidhur me qasjen në informata për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), në Qendrën e tyre.
2. Parashtrimi i kërkesës në DKA për vizitë në shkollat ku kanë fëmijë/ nxënës me Aftësi të Kufizuara.
3. Te ndryshme – kemi diskutuar në lidhje me Raportimin e aktiviteve që i kemi realizuar në periudhën Shtator – Dhjetor 2019.

Megjithëse, kishte propozime nga anëtarët e Komitetit për orarin e mbajtjes së mbledhjeve, me ç'rast unanimisht grupi vendosëm që mbledhjet të realizohen ditëve të premte në vendin e zakonshëm, përkatësisht në zyrën pranë bufësë në komunën e Drenasit.

Bazuar në aktivitetet e planifikuara, ne si Komitet Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në komunën e Drenasit, në bashkëpunim me OJQ dhe Drejtoritë komunale që kontribuojnë në aspektin e përmirësimit të gjendjes së Personave me Aftësi të Kufizuara, kemi vlerësuar të dobishme përpjekjet për të punuar në drejtim të hartimit të Planit të Veprimit 2020-2022 për Persona me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Drenasit. Kjo iniciativë dhe të tjera, rrjedhin si rezultat i identifikimit të problematikave me të cilat ballafaqohen Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK) në komunën tonë.

Siç kemi identifikuar, realiteti aktual për PAK, është ende larg realizimit të të drejtave të tyre, sepse ata janë grupi më i marginalizuar i shoqërisë, të cilët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e veta ligjore dhe më elementare, qoftë në lidhje me shërbimet shëndetësore, arsim, qasje jo e duhur ndaj personave me aftësi të kufizuara në shërbimet administrative dhe më gjerë, madje përfshirë edhe të drejtën për punësim, ku dihet se ligjshmërisht, çdo i pesëdhjeti i punësuar duhet të jetë PAK, ose 2% e të punësuarve.

Burimet e raportit përmbledhës të aktiviteteve të realizuara për vitin 2019 janë ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve/takimeve të Komitetit. Raporti, pas miratimit në mbledhje të Komitetit, do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komunës së Drenasit.

Pa dyshim që gjatë punës sonë për vitin 2019 kemi nxjerr rezultate konkrete me anë të aktiviteteve dhe angazhimit tonë, por gjithashtu kemi hasur edhe në kufizime apo barriera të lehta të cilat kanë pamundësuar realizimin e disa aktiviteteve në kohën e planifikuar.

#### Rezultatet

- Kemi lidhur bashkëpunim të ngushtë me HANDIKOS në Drenas, dhe me anë të partneritetit të krijuar kemi identifikuar aktivitetet që realizon kjo OJQ, çfarë është sfida për ta, dhe çfarë është e nevojshme që ata të vazhdojnë të kontribuojnë për PAK.
- Ngushtësisht jemi në kontakte të vazhdueshme me drejtorë dhe mësimdhënës shkollash të komunës së Drenasit, të cilët ofrojnë shërbimet e nevojshme për fëmijët me Aftësi të Kufizuara.

#### Kufizimet

- Mos realizim i takimeve me më shumë drejtorë dhe zyrtarë të institucioneve komunale, si p.sh. takime me drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, në mënyrë që të nxirren rekomandime të përbashkëta për të parë mundësitë për PAK, për aktivitet kreativ, zhvillimin e ndonjë loje nga PAK etj.
- Mos realizimi i vizitave në shkollat ku fëmijë me aftësi të kufizuara frekuentojnë mësimin, identifikimi i saktë për të gjitha shkollat e komunës së Drenasit në lidhje me mësuesit mbështetës dhe asistentët që u ofrojnë shërbimet e nevojshme nxënësve me aftësi të kufizuara në këto shkolla, e gjitha kjo si rezultat i neglizhimit të bashkëpunimit nga zyrtarë kompetent nga DKA për sigurimin e këtyre informatave.

Disa nga propozimet për vitin 2020:

- Bashkëpunimi me OJQ dhe drejtoritë komunale, në aspektin e hartimit të një dokumenti siç është Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2020-2023
- Realizimi i takimeve me zyrtarë dhe donatorë për të rikujtuar iniciativat p.sh. për rritjen e numrit të asistentëve, meqë është miratuar Ligji.
- Përpjekje në gjetjen e mënyrave për të ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe rregullimit të pjerrinave në ato hapësira ku PAK kanë qasje dhe detyruesisht duhet të marrin shërbimet e nevojshme.
- Takime të rregullta me kryetarin e komunës së Drenasit, si dhe me përfaqësues të tjerë nga Kuvendi Komunal, për të shkëmbyer ide dhe përvoja në këtë fushë.

### (III) PJESA PËRMBYLLËSE

#### KONKLuzionet me Rekomandime

Përgjatë periudhës së ardhshme për tre vite, të funksionimit të Komitetit dhe sipas këtij raporti mund të konstatohet se problemet e PAK në Komunën e Drenasit janë të shumta, me theks të veçantë, në punësim, temë kjo e cila i prekë më së shumti PAK. Megjithatë, Komiteti njih një gatishmëri më të madhe të institucioneve komunale të Drenasit për t'i përmbushur obligimet ligjore për PAK, por thirren në kufizimet ligjore dhe buxhetore në realizimin e të drejtave të PAK, veçmas në sferën e punësimit.

Mbështetur edhe në të cekurat e raportit, Komiteti nxjerr këto rekomandime:

- ♦ Definimi i prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhet të ndërmerr nga Kuvendi i Komunës dhe Shoqëria Civile për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me personat me aftësi të kufizuara në secilin sektorë.

- ♦ Komiteti Konsultativ të propozoj dhe ndihmoj drejtoritë përkatëse për hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi në fushën e Aftësisë së Kufizuar.

- ♦ Punëdhënësit në nivelin lokal të jenë fokusi primar i evokimit për zbatim të kornizës ligjore për punësimin e PAK, e cila kornizë përcakton qartë formën dhe mundësinë për punësimin e tyre.

- ♦ Të promovohen lehtësirat ndaj kontraktorëve biznesor që kanë apo zotohen të punësojnë PAK, sipas legjislacionit dhe Planit të Veprimit 2020-2023, për PAK në komunën e Drenasit.

- ♦ Anëtarët e Komitetit ta rrisin ndikimin e tyre te zyrtarët komunalë për punësim më të madh të PAK dhe për sigurimin e të drejtave të barabarta sociale.

Anëtarët e Komitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara në Drenas:

1. Shemsi Bërbatovci – kryesues
2. Ariana Isufi – zëvendës kryesues
3. Arlindë Krasniqi – anëtare
4. Burim Fazliu – anëtar
5. Jehona Abdyli - anëtare

**Petrit Sinani;** Për mendimin tim ky është një nder raportet më të mira që kanë ardh deri më sot në Kuvendin Komunal, dhe e përgëzoj znj. Isufi. Ishte një raport jashtëzakonisht përmbledhës e cila ka sipas mendimit tim çdo gjë që duhet me pas një raport, këta kanë treguar se kjo duhet të jetë punë e komiteteve dhe kjo u takon zyrtareve komunal me implementu këtë raport, ju përgëzoj për këtë komitet.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj;** Hapi diskutimin për piken e shtatë të rendit të ditës:

## **7. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar – dhjetor 2019.**

**Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku;** Pasi përshëndeti të gjithë, i njoftoj në pika të shkurtëra me realizimin e të hyrave të cilat kemi arrit deri në këtë periudhë kohore, të cilat deri më tani nuk janë përfshirë detajisht në këtë raport, sepse raporti është bërë para datës 15 janar, të hyrat e realizuara për vitin 2019 për periudhën janar –dhjetor është 1,885,542,14 € gjegjësisht është 43.83 % tejkalim i planit buxhetor për vitin 2019, sa i përket të hyrave që kemi arrit me i siguruar jashtë buxhetit të vijave buxhetore të buxhetit të vitin 2019 nga Ministritë e linjës kemi pas investime të cilat janë kryer dhe janë regjistruar sistemin e pasurisë e Komunës së Drenasit për këtë periudhë kohore janar –dhjetor kemi : 818,756 të cilat nuk përfshihen në buxhetin tonë por regjistrohen si pasuri komunale e Komunës së Drenasit, edhe një njoftim të shkurtet sa i përket pasurisë e Komunës së Drenasit, ju njoftoi se Komuna Drenasit për periudhën e lamë pas për vitin 2019 pasuritë totale të komunës nder vite janë: 508,301,478, 94 € ku vlerën kryesore,

jem komunë e pasur nuk jem prej komunave që s'kemi buxhet, toka është 473,264.090.10€, ndërtesa i kemi 16,537,108 nuk është raport financiar ky është një njoftim shtesë për raportin raportin e keni të shkruar nuk kam dashur të ju marr kohë, pajisje i kemi 206.803.80 infrastrukture dmth. kanalizim, ujësjellës, energji elektrike rrjet kemi 14.426.789 automjeti kemi 230.000 kapital tjetër kemi 1,312,160 € investimet e projekteve të cilat kanë filluar në vitin 2019 dhe janë dy vjeçare ose tri vjeçare numërohen si investime në vijim 2.304.682. 25 € dhe pasuri fikse i kemi dhe pasuri fikse i kemi 19,844,46 € vlera totale e pasurisë është 508,301,478, 94 €, tek totali i pasurive kemi edhe pasuritë që i kemi nën vlerën 1000 € që janë realizuar dhe pas amortizimit dhe përcaktimit të vlerës totali i pasurive nën 1000 €, në vitin 2019, është 280,805,09.

**Vehbi Berisha;** Tek investimet kapitale të tabela e përgjithshme fq. nr.7 zakonisht investimet kapitale janë pika më e ndjeshme që i atakon të gjithë qytetet e Drenasit dhe nese e bënë një kalkulim në mes vlerës së ndarjeve si pasuri e MFK-së dhe shpenzimeve për vitin 2019 del se kemi një dallim prej 1 milion €, ose konkretisht tek çështja e Drejtorisë së infrastrukturës kemi për mbi 600 mijë €, dua ta di sa prej këtyre është vlera e shumës së mjeteve të cilat nuk mundemi me i rialiku në vitet vijuese për shkak se është shumë e rëndësishme me ditë se çka po humbemi.

**Drejtori i Financave Shyqiri Bublatku** - shuma e investimeve kapitale për vitin 2019 prej buxhetit të çertifikuar i cili ka qenë 4 milion e 611 € komuna ka arrit me realizuar të hyra dhe tejkaluar planifikimin e të hyrave dhe me çu shifrën 5 milion 652,35 prej tyre janë shpenzuar në periudhën raportuese dmth 1 janar 31 dhjetor 2019, 4 milion 543,963,46 ,tendi i shpenzimeve për investimet kapitale është 80.39% mjete të cilat dmth janë realizuar deri në këtë periudhë kohore pjesa dërmuese në veçanti kujdes i veçantë i është kushtuar vlerës për parane çfarë do të thotë vlera për parane si kuvend komunal si kryetar si njesi si ekzekutiv jemi interesuar që vlerën e parasë ta ruajmë mos të bëjmë investim vetëm shkel e shko, por të kryhen punët ashtu si parashihet për atë shërbim për atë pagesë që e bëjmë të marrim shërbimin e plotë për të dhe kjo ka ndikuar që në mos të kemi një përqindje 90%-92% po mendoj të investimet kapitale ju ka kështu kujdes i veçantë investimit ku po investojmë sa po investojmë dhe çka po marrim me investimin që po e bëjmë kualitetin apo cilësinë e shërbimit, pjesa dërmuese e bartjës, kjo bartje prej shumës që e ceket ju, janë të hyra vetanake nese e shikojmë raportin e freebalancit ,nese me lejohet si shkurt ne i kemi këty 1.313,535 të hyra buxhet të planifikum të hyra vetanake për periudhën raportuese që janë bart janë hedh në sistem dmth i kemi pasur në disponim kane qenë 1.380 mijë dmth është një tejkalim shpenzimi i tyre është 732,609 mijë € realizimi i të hyrave vetanake, për periudhën në të cilën po flasim është 1 milion 885 mijë mbetje të cilat nuk kanë qenë të parapara me planifikim të buxhetit, i kemi realizuar, kemi tejkaluar planin, ato mjete duhet të bartën sivjet dmth prej vitit 2019 në vitin 2020.Në vitin e kaluar kemi pasur 811 mijë € bartje.

**Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci-** Prej grandeve qeveritare i kemi rreth 250 mijë euro që nuk mundemi me i aloku, i kemi në Breg të Qyqavicës 50 mijë euro për arsye se 1 muaj e 4 ditë agjencioni i pyjeve na ka vonuar me na dhënë një pelqim, ai buxhet ka ardh si rezultat i një mbledhje të jashtëzakonshme që e kemi mbajt me e bë një momerandum mirëkuptimi me Komunën e Skenderajt, jemi të vetmit në Kosovë që e kemi fituar, buxheti tjetër që e kemi humb është të rruga e Zhilivodës e Ujësjellësit këto janë që nuk kemi mundur sepse na kanë vonuar në kohë, ne e kemi sjellë tenderin diku në muajin tetor dhe kemi pas vonesa në

përgjigje afër 1 muaj e 4 ditë. Këto tjerat janë bartje janë bartje që nuk kanë humbur janë këtu për nevoja të qytetareve.

**Petrit Gashi-** Prej vitit në vit sa herë që kemi bartje apo mbetje të mjeteve shpesh herë kemi dëshirë me ditë vetëm sa na i marrin jo sa na kanë tepruar, ne duhet me e s'pjegju qartë në bazë të planifikimeve tona që i kemi bërë në bazë të investimeve në këtë vit na kanë tepruar 1,248,278 € këto mjete nuk janë shfrytëzuar gjatë këtij viti, ne mundemi me i bartë të gjitha nëse na lejon ligji prej viti në vit, por problemi është se neve na intereson se infrastruktura napër fshatra është jashtëzakonisht e keqe dhe problemi më i madh është tek infrastruktura, unë e di që në fshatin tim dhe shumë fshatra tjera që nuk janë realizuar prioritetet ato që kanë ardh këtu, ndersa paret kanë tepruar, këtë vit kanë tepruar 1,248,278 € ne mundemi me i bartë të gjitha por te jeni të sigurt se kjo është si rezultat i mos menaxhimit të mirë dhe mos planifikimit të mirë. Shumica e planeve infrastrukturore neper fshatra janë të pa përfunduara dhe ende nuk kanë filluar.

**Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku-** Rruga qe e përmendi edhe kryetari është 670 mijë euro, projekti i ujësjellësit nuk kemi mundur me i zhvillu sepse është në procedurë gjyqësore, dhe ajo është ne shume prej 200 e diçka mije euro, duhet t'i kemi parasysh këto rrethana kushtesh ne rrethana të cilat jemi ballafaquar.

**Petrit Gashi-** Në këtë kuvend disa asamblist e kanë ngrit çështjen e 22 fshatrave të cilat nuk mundeni me kry ujësjellesin, ju duke e ditë që nuk mundeni me e kry një projekt të tillë.

**Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku-** Informoj mjetet të cilat kanë shkuar nga grandit qeveritar për investime kapitale e cekem 259,57.00 € janë mjete të cilat nuk barten që shkojnë suficit por shkojnë në buxhet të Kosovës, të grandet e të hyrave vetanake janë mjete të cilat i kemi realizuar ne dhe të cilat barten në vitin 2020 si dhe vitit të kaluar që janë diku afër 194 mijë euro edhe ato mjete barten ne vitin 2020, kemi edhe grandin e performances që e kemi fituar vitin e kaluar i cili edhe ai bartet në vitin 2020, dhe besoj që nga muajt shkurt do të barten ne buxhetin e Komunës së Drenasit.

**Sokol Bylykbash-** Dua të flas pak për kategorinë e investimeve kapitale, kishte një mbetje suficit rreth 700 mijë euro, nuk e di sa janë grande sa janë të hyra vetanake, ndoshta e keni sqaruar, por unë dua ta përmendi një fakt që kur e keni sjellë draft buxhetin që e kemi miratuar edhe për këtë vit por edhe për vitin tjetër në atë buxhet brenda një kodi kemi pas tri deri në katër fshatra dhe arsyetimi ka qenë: po e bëjmë këtë formë për arsye se zyra e prokurimit e ka ma të lehtë me i krye procedura te veta dhe i kryen ma shpejt me qëllimin që mos me pas mbetje, në një far mënyre jemi pajtuar edhe pse kemi kërkuar me pas një dokument shitesë zyrtar i cili na jep neve detaje, por edhe pse ka ndodh kjo prapë ka suficit, suficiti është goxha i lartë.

**Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci-** Unë dhe ju kemi votuar për atë çështje për me e zvogëluar numrin e tenderëve nga 200 tenderë e kemi zvogëluar diku 80 ose 90 tenderë, vitin tjetër derisa ta zvogëlojmë në 40, por kemi më e bë infrastrukture- rrugë kemi me e bë kaq, kanalizim të ujërave të zeza kaq, ujësjellësit kaq, ne suficit i kemi vetëm 250 mijë euro, grandet i kemi zhvilluar 97.40 % kështu që ne mos me pas pengesa tjera siç i ceka më lart, mos me na pas pengu institucionet tjera i kishim harxhuar të gjitha mjetet.

**Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj-** Pasi që kjo pikë e rendit të ditës nuk votohet kalojmë të pika e radhës.

**8. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit.**

**Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci-** Ju e keni një material ku ja kemi sjell për pronat që kanë qenë në shfrytëzim pronat e komunës nga qytetarët tanë. Ligji nr. 06/092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së pa luajtshme të komunës respektivisht neni 23 paragrafi 1-2 ju njoftoj se komuna e Drenasit gjatë vitit paraprak ka lidhur disa kontrata për nën shfrytëzim të pronës së pa luajtshme të komunës në të cilat kontrata ju ka kaluar afati i shfrytëzimit 10 vjeçar, ne e dimë që këto kompani ose këta qytetarë që kanë investuar në këto prona kanë investuar shumë dhe unë dua me gjete një rrugë se si të ja vazhdoj kontratat këtyre shfrytëzuesve të pronës publike. Ne kemi kërkuar nga MAPL-ja një përgjigje dhe përgjigja e tyre ka qenë të veprojmë sipas ligjit.

**Sokol Bylykbashi-** E pashë komunikimin me ministrin përkatëse, ju e keni sjell kryetar një dokument ku na jepni disa informata, si pronari, koha e shfrytëzimit të pronës, sipërfaqja, lokacioni e kështu më radhë, mirë po në shkresën e ministrisë thuhet që kryetari i komunës obligohet që ta njoftoj kuvendin e komunës pas përfundimit të kontratës së dhënë në shfrytëzim të pronës së pa luajtshme të komunës duke përshkruar gjendjen aktuale të pronës, pra në bazë të kësaj që shohim nuk është e shkruar ajo që ka kërkuar edhe vet ministria pra gjendjen aktuale të pronës që do të thotë sa është vlera e pronës, sa punëtor janë në këto biznese për shkak që dihet kur e japim pronën në shfrytëzim dihet se përveç përfitimit që e kanë njerëzit që merren me veprimtari biznese, qëllimi është me ju rrit vlera e pronës së komunës . Sa i përket destinimit po e kuptoj edhe unë se këto janë prona që njerëzit kanë investuar shuma të mëdha dhe ne jemi për të ja vazhduar vetëm se gjithçka duhet me qenë transparente dhe të jemi të qartë rreth këtyre pronave.

**Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci-** Ligji e thotë gjdo pronë që ka mbushur 10 vite komuna e merr në shfrytëzim, kur të vije koha të bëhet shpallja publike për atë pronë ne caktojmë vlerat e pronave dhe i thërrasim ofertuesit. Askund nga përgjigja e MAPL-së nuk shkruan sa ka investuar apo sa punëtor i ka por duhet të i marrim të gjitha pronat që kanë qenë në shfrytëzim 10 vite.

**Sokol Bylykbashi-** Atë që ethe ti është e vërtetë propozim vendimet për vazhdim duhet patjetër për me u cek do të thotë kritika ime është e arsyeshme.

**Nexhmedin Balaj-** Disa sqarime që desha me i dhanë i dha edhe kryetari , por këtu po thotë që gjendja aktuale e pronës ti japë propozimet për destinimin e saj në të ardhmen, këtu shumë mirë është e cekur në njoftim si thotë: për pronat e lartcekura propozoj për të njëjtat duke u bazuar në nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të ligjit 06/092 për dhënien në shfrytëzim të pronës, ku thotë në pronën e paluajtshme të pronës së komunës mund të bëhet profiti, pra komuna jonë në të ardhmen me pas profit ekonomik nga këto prona të jepen prapë në shfrytëzim pasi që sipas planit zhvillimor komunal në ato prona nuk është paraprak ndonjë investim nga ana e komunës, pra të gjitha procedurat kryetari i ka ndjek dhe na ka informuar që prap në të ardhmen do ta shpallim.

**Sabrije Kuka-** E ceku edhe z. Balaj, këto shpallen pasi ju ka skaduar afati i përdorimit, shpallet ofertojnë personat që i kanë bizneset aktuale aty normal edhe ofertues tjerë, normalisht ne nuk ia marrim atyre që kanë investuar në ato prona, dhe përsëri vazhdojnë më punën e tyre ku kanë mbet, por ne duhet t'i ndjekim procedurat tona.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Pasi që edhe kjo pikë e rendit të ditës nuk votohet kalojmë të pika e radhës.

#### **9. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020. E plotësuar.**

**Petrit Sinani;** Siç po e shihni edhe ju realisht e kam marrë këtë vendim edhe përgjigjet komplet të ministrisë jo vetëm të një ministrie të caktuar dhe normalisht ata i kanë dhënë rekomandimet e tyre se si duhet të veprojmë për shkak të disa mos pajtimeve ndërmjet aktit të komunave shqyrtimit të ligjshmërisë, këtu janë të cekura rekomandimet nga secila ministri se çka duhet të ndryshohet dhe normalisht që ne do t'i marrim të gjitha hapat e nevojshme për të bërë ndryshimet tek secili nen. Ne i kemi bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme ju ftoj ta votoni!

**Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj-** Pasi nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, ku të pranishëm ishin 18 anëtar!

*Për votuan 18 anëtar.*

*Kundër s'ka.*

*Abstenim s'ka.*

#### **Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj:** Hapi diskutimin për pikën e dhjetë: **10. Të ndryshme.**

**Vehbi Berisha-** unë desha me diskutuar një çështje, mendoj që është e rëndësishme për tu trajtuar për shkak se edhe qytetaret kanë protestuar lidhur me këtë çështje, me dt. 20.06.2019 në atë kohë përfaqësuesi i lagjes Berisha në fshatin Gllanasellë bashkërisht me kryetarin e fshatit e ka dorëzuar një kërkesë për shtrimin e një trotuari me nr. të protokollit 15.070-35759 mirëpo pas andej kemi kuptuar, personalisht kam kuptuar që ai trotuar ka me u shtrur tek lagja "Nika" dhe besoj që edhe ju e dini që rruga kryesore është më e frekuentuar dhe fëmijët janë më të rrezikuar, unë me shqetësim e kam shikuar në lajme protestën e banoreve të lagjes "Nika" që ata pretendojnë që rruga e tyre me kthi në trotuar, kisha dashtë një sqarim pse ka ardh deri tek kjo?

**Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci-** kërkesat jashtë parashikimit buxhetore pas dëgjimeve publike janë të pavlefshme, ne kur e ndajmë buxhetin kur e përcaktojmë, me na sjellë një kërkesë dikush me realizu nuk mundemi me realizu, qëllimi i largimit të trotuarit nga rruga kryesore në rrugën në mes të fshatit ku frekuentojnë më shumë se gjysma e fëmijëve të fshatit nëse nuk pajtohesh me mu se kjo është më mirë për fëmijët dhe gjysmën e fshatit që të ikin nga rreziku i komunikacionit që e cekët ju është çështje tjetër. Pra në pronat e juaja në rrugën kryesore nuk më kanë lejuar qytetarët që ta kalojmë në pronë private, rruga hynë në pronë private, ka shumë që i kanë pranë po ka edhe nga ata që nuk më kanë lejuar. Unë ju kam treguar që nuk investoj më në pronë private ku nuk më lejojnë qytetarët me e perfundu projektin pa e shpronsu pronën. Rruga

ku e kemi derguar trotuarin është pronë publike, arsyja ka që fëmijët që fëmijët mos të jenë të rrezikuar. Rruga Gradic- Drenas, "Guri Plakes" Ceralevë-Komoran, rruga kryesore kanë nevojë për trotuar sepse janë rrugët më të frekuentuara ku nuk mundem ta bëjë, unë jam i detyruar të bëjë rrugë publike. Unë kam asfaltu atë rrugë dhe ska asgjë që e ndalon në pronë publike. Kur të vendosni t'i me lagjen tuaj të më ndihmoni mos të kenë probleme për pronë private atëherë edhe unë do jem i gatshëm të asfaltoj sepse unë tani nuk mundem me investu këtë trotuar pa e shpronësuar pronën private dhe të vendoset në interes të përgjithshëm.

**Vehbi Berisha-**Vetëm desha me të informuar se edhe ne nuk kemi ndejtur duarkryq për me ndihmu sepse ky trotuar ka të bëjë më së shumti për fëmijë, qëllimi është që fëmijët të kenë një ecje më të sigurt mirëpo unë kam pyetur se pse është ndalur trotuari të rruga kryesore që është jetike për shkak që ecim ne që atë nuk mundesh as me ec këmbë, kushdo që ecë është i rrezikuar. Unë kam marrë informata që një pronar i një toke që quhet "Tafil Nika" komuna më herët ja ka marrë do pronë dhe nuk ja ka kompenzu kështu kam marrur informatë sa është e saktë nuk e di, ata kanë thënë se janë ankuar të ju dhe e kanë paraqitur këtë rast.

**Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci-** z.Berisha ajo rrugë është shtruar në vitet e 80-ta nga Osman Berisha, dhe jam shumë falënderues për punët që i ka bërë nëse nuk ja kanë paguar nga vitet e '80-ta nga unë nuk mundet me kerku kompensim, le ta ketë të qartë çdo njëri se kompensimet nuk mundem t'i bëjë unë të viteve të 80-ta ato duhet të dërgohen në procese gjyqësore dhe të kërkojnë dokumentet. Nëse na dëshmon me dokumente se janë në rregull atëherë nuk do ketë kurrfarë problemi.

**Arta Xhyllani-** deshta me diskutu rreth rrugës "Lulzim Tahiraj" e cila është diskutu tash e dy vite, kjo është rrugë tranzit që e ndërlihd rrugën me "Nazmi Gashi" të Sankoci dhe tek "Gjosht" dhe prapë nuk është ndërmarrë asgjë, unë e di se tash drejtori i ri ka me marrë pak me ma prioritet por vetëm desha me ditë edhe qytetarët me dit pak a shumë se ku është kjo çështje se pak e di që duhet kanalizim dhe asfaltim por besoj që duhet qasje ma konkrete për qytetarët e Komoranit. Çështja tjetër që desha me diskutu është për drejtoreshën e shërbimeve publike, prapë është e njëjta çështje për qenët endacakë, e di që ndoshta nuk është shumë përgjegjësi e juaja mirëpo kërkoj një përgjigjeje nga ju dhe të ndërmerren masa që mos të vjen deri të ndonjë rast me fatalitet në Komoran mirëpo edhe ne vendet tjera.

**Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci** – Kjo rrugë është në projekt për sivjet, i kemi 3 projekte për sivjet, kanalizimi i ujërave të zeza, vërshimet atmosferike, asfaltimi, pa përfunduar dy të parat nuk mund të përfundohet e treta se nuk mundemi më investu e me prish asfaltin e prapë me rregullu. Sa i përket qeneve krejt buxhetin e ka marrë AVUK-i, ju mund t'i drejtoni kërkesat atje sepse ne nuk kemi me çka me luftu kur kemi pasur kemi marrë masa.

**Sokol Bylykbashi-** E kam një propozim që në fakt nuk është i imi por është i Shemsi Elezit, sot është një përvjetor jubilar i rënies së dëshmorëve me rastin e proteste së 31.01.1990 dhe ne të gjithë që jemi këtu bëmë homazhe në vendin e rënies, propozimi është që në ai vend të behët më praktik më i dinjitetshëm, të bëhet një përmendore një platformë sigurisht aty në mënyrë që vizitorët e tjerë të kenë më të lehtë po ashtu edhe ne, se edhe ashtu siç po duken ato pllakat afër asfaltit po mendoj që nuk është mirë me lënë ashtu, e di që po besoj që s'jam gabim është pronë

e hekurudhave, por çfarë do të kishte mundur të bëjë kryetari edhe ne si komunë që brenda një kohe me rregullu atë vend.

**Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci** –Sokol ata që janë vrarë janë vra bash mbi hekurudhë mbi shina të hekurudhës nëse po flasim për vend, e dyta atë hekurudhë kemi më e bërë urë për rrugë me katër korsinë anë të djathtë drejtë stacionit të autobusit, dhe një rreth. Një përmendore pse jo, por në atë pjesë duhet me gjet një vend një kënd për me vendos. Për këtë çështje dërgoj kërkesat tek Bislimi që është për përkujdesjen e monumenteve dhe kanë buxhet dhe janë enkas për këto çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj**- Edhe un kam një kërkesë të stacionet e autobusëve zakonisht ku presin qytetarët, është kërkesë brenda mundësive buxhetore nëse nuk realizohet sivjet mund të realizohet edhe në vitin e ardhshëm kërkesa është që ku presin qytetarët të ketë një mbulojë apo stacion që qytetarët të kenë një mbrojtje kur ka reshje atmosferike.


**Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci** – Ne i kemi filluar jemi duke i përfunduar pllatot e parkingut të stacioneve të autobusëve nëpër këto stacione, pasi t'i përfundojmë këto pasi i kemi pasur do kufizues edhe me të drejtë na ka kritikuar Petrit Gashi në Llapushnik po du me thënë në rrugët lokale jo kryesore, këta i kanë i kanë bërë edhe rrugët kryesore regjionale i ka niveli qendror, kemi me fillu me i ndërtu po po kemi probleme me kombibusa.

Pasi nuk pati diskutime tjera, vërejtje apo sugjerime **Kryesuesi i Kuvendit z.Labinot Halilaj** konsideroj të mbyllur seancën.

**Mbledhja Përfundoi në ora 14:45 min.**

*Drenas 31.01.2020*

Procesmbajtëse:



**Zahrie Podrimqaku Subashi**



**Kryesuesi i Kuvendit**

**Labinot Halilaj**